



SKEMA E GRANTEVE IPARD II 2014-2020

UDHËZUESI PËR APLIKANTËT

THIRRJA E IV-TË PËR APLIKIME

10 Janar 2022 - 25 Shkurt 2022

MASA 7 (Vetëm sektorët

Turizmi i natyrës dhe ai rural, Industria e artizanatit dhe punishtet e prodhimit,)

***Sektorët e tjerë nuk përfshihen**

**MBËSHTETJA E GRANTEVE ËSHTË BASHKËFINANCUAR NGA BASHKIMI
EVROPIAN DHE QEVERIA SHQIPTARE**

Kontributi i BE - 75%

Kontributi i Qeverisë Shqiptare - 25%

Përmbajtja

1. Objektivat, Prioritetet dhe Masat për Programin IPARD II	2
2. Hyrje	2
3. Objektivat e Programit IPARD II për periudhën 2014-2020	3
1.3 Përkufizimet kryesore	4
4. Masa 7: “Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Biznesit”	5
4.1 Intensiteti i ndihmës nën Masën 7	5
4.2 Aplikantët e pranueshëm nën Masën 7	6
4.3 Investimet e pranueshme nën Masën 7	7
5. Rregullat për shpenzimet e pranueshme	8
5.1 Shpenzime të Pranueshme	8
5.2 Shpenzimet jo të pranueshme	10
6. Procedura e Aplikimit	11
6.1 Përmbajtja e Aplikimit	11
6.2 Dorëzimi i Aplikimeve	13
6.3 Informacione të Mëtejshme për Aplikantët	14
7. Përzgjedhja, Kontraktimi dhe Zbatimi i Procedurës	14
7.1 Procedura e përzgjedhjes	14
7.1.1 Kontrolli i Dokumentacionit dhe i Pranueshmërisë	14
7.1.2 Vlerësimi i Propozimit Teknik të Projektit dhe/ose Planit të Biznesit	15
7.1.3 Kontrollat në Vend	16
7.1.4 Renditja e Aplikimeve	16
7.2 Vendimi për Dhënie të Grantit dhe Njoftimi i Aplikantëve	17
7.3 Kushte të Zbatueshme për Kryerjen e Investimeve	17
7.4 Pagesa e Grantit	17
7.4.1 Përmbajtja e kërkesës për pagesë	18
7.4.2 Dorëzimi i Kërkesës për Pagesë	19
7.4.3 Informacione të Mëtejshme për Aplikantët	19
7.5 Monitorimi ex-post	20
8. Shënime të Rëndësishme për Aplikantin lidhur me Refuzimin e Aplikimeve	20
Lista e Aneksëve	22

1. Objektivat, Prioritetet dhe Masat për Programin IPARD II

2. Hyrje

Instrumenti i Ndhmës së Para-Aderimit (IPA II) 2014 - 2020 është mjete kryesor i përdorur nga Bashkimi Evropian (BE) për të ofruar mbështetje financiare dhe teknike për vendet e zgjerimit. Objektivi i përgjithshëm i IPA-s për Shqipërinë është të mbështesë reformat dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për të arritur pajtueshmërinë me ligjet e BE-së për të përgatitur plotësisht vendin për të marrë detyrimet e anëtarësimit në BE.

IPA ka një fushë të Politikave të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (IPARD II), i cili u ofron ndihmë vendeve kandidatë të BE-së për zbatimin e programeve shumëvjeçare që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe zonave rurale dhe përgatitjen e tyre për zbatimin e politikave të BE-së.

Autoriteti Menaxhues në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është përgjegjës për përgatitjen e programit IPARD II.

Programi IPARD II për Shqipërinë u miratua zyrtarisht me Vendimin e Komisionit C (2015) 5073 të datës 20 korrik 2015, pas mendimit të favorshëm të Komitetit IPA II më 30 qershor 2015. Struktura operacionale IPARD (Agjencia e Pagesave - Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural/ AZHBR dhe Autoriteti Menaxhues i MBZHR) janë përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e programit të ardhshëm IPARD II.

Kontributi maksimal i BE për fondet IPARD II në Euro për vitet, 2014-2020 *

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
Totali	-	-	13,000,000	14,000,000	12,000,000	16,000,000	16,000,000	71,000,000

* Kontributet vjetore janë thjesht indikative pasi shumat aktuale do të vendosen çdo vit në kuadrin e buxhetit të BE.

Ky Udhëzues për Aplikantët përcakton rregullat për paraqitjen, përzgjedhjen dhe zbatimin e investimeve në masën 7: “Diversifikimii Fermave dhe Zhvillimii Biznesit” të Programit IPARD II.

Kopje të këtij Udhëzuesi së bashku me të gjithë informacionin që lidhet me thirrjen e katërt mund të shkarkohet në adresat: www.bujqesia.gov.al, www.azhbr.gov.al dhe www.ipard.gov.al.

3. Objektivat e Programit IPARD II për periudhën 2014-2020

Objektivat dhe prioritetet e masave të Programit IPARD II të përzgjedhura janë në përputhje me objektivat e Dokumentit Strategjik Kombëtar (DSK) dhe kontribuojnë për:

- Mbështetjen e investimeve në sektorin agro-ushqimor me qëllim përmirësimin e konkurrencës, pajtueshmërinë me standardet e BE-së dhe ruajtjen e natyrës dhe mjedisit;
- Mbështetjen e investimeve në zonat rurale me qëllim diversifikimin e ekonomisë rurale dhe krijimin e biznesit, duke çuar në përmirësimin e mundësive të punësimit dhe përfshirjes sociale.

Masa 7: “Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Biznesit”

Objektivat e përgjithshme të masës janë:

Nxitja e punësimit përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe mbajtjes së atyre ekzistuese përmes zhvillimit të veprimtarive të biznesit, duke rritur në këtë mënyrë nivelin e veprimtarive ekonomike të zonave rurale, duke rritur drejtë për së drejti të ardhurat e familjeve fermere dhe shmangur braktisjen e zonave rurale, duke kontribuar në një balancë më të mirë territoriale si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social.

Objektivat specifike të masës janë:

Nxitja e krijimit, diversifikimit dhe zhvillimit të veprimtarive rurale përmes mbështetjes së investimeve në diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e veprimtarive jo-bujqësore në sektorët e mëposhtëm:

1. Prodhimi i bimëve medicinale aromatike, kërpudhave, mjaltit, bimëve dekorative dhe kërmijve;
2. Përpunimi dhe tregtimi i bimëve medicinale dhe aromatike të egra dhe të kultivuara, kërpudhave dhe mjaltit;
3. Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore;
4. Akuakultura;
5. Turizmi i natyrës dhe ai rural;
6. Shërbime për popullsinë dhe bizneset rurale;
7. Industria e artizanatit dhe manufakturës;
8. Prodhimi i energjisë së rinovueshme.

Buxheti i përgjithshëm indikativ në kuadër të Programit IPARD II është gjithsej **94,337,255 EURO** nga të cilat **71,000,000 EURO** është kontributi i BE dhe **23,337,255 EURO** është kontributi kombëtar.

Në thirrjen e katërt për aplikim, sektorët e pranueshëm të kësaj mase, janë si më poshtë vijon:

1. Turizmi i natyrës dhe ai rural;
2. Industria e artizanatit dhe manufakturës;

Buxheti përgjithshëm për thirrjen 4 për masën 7 me sektorët e sipërpërmendur është 4.1 milion euro, ku 75 % kontribut i BE dhe 25 % kontribut i shtetit shqiptar.

* Ky buxhet mund të rritet deri në 5.2 milion euro në varësi të vendim-marrjes së Komisionit Europian, dhe disponueshmërisë së fondeve të dedikuara për Masën 7.

Tabela më poshtë specifikon seksionet e Udhëzimit, e cila zbatohet për masën 7 si dhe dispozita të përbashkëta:

Rregullat e pranueshmërisë	Masa 7
Shuma e projekteve dhe granteve të investimit	Seksioni 4.1
Pranueshmëria e aplikantëve: kush mund të aplikojë për grantin	Seksioni 4.2
Pranueshmëria e investimeve: investimet për të cilat mund të kryhet një aplikim	Seksioni 4.3
Pranueshmëria e shpenzimeve: Llojet e shpenzimeve të cilat mund të merren parasysht gjatë caktimit të shumës së grantit	Seksioni 5
Procedura e aplikimit: përmbajtja dhe dorëzimi i aplikimeve	Seksioni 6
Përzgjedhja, kontratimi dhe zbatimi i investimit (projekti)	Seksioni 7

1.3 Përkufizimet kryesore

- **Aplikuesi:** është person fizik ose juridik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), që paraqet një kërkesë për ndihmë në bazë të Thirrjes për Aplikime;
- **Përfituesi (ose përfituesi i grantit):** është një person fizik ose juridik i regjistruar në QKB, që përfiton ndihmë nga IPARD II;
- **Aktivitetet e investimeve (projekti):** përbëhet nga një sërë veprimtarish për investime në asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, duke synuar objektivat e sektorëve të mbështetur;
- **Shpenzimet e përgjithshme:** përfaqësojnë një shpenzim të referuar për inxhinierët dhe tarifatat e tjera të konsultimit, studimet e fizibilitetit, fitimin e të drejtave të patentës ose licencave;
- **Ndihma:** është një pagesë nga Autoriteti Kontraktues që rimbursos një pjesë të shpenzimeve të pranueshme të bëra nga përfituesi për investimin (projektin) në aktivet e luajtshme dhe të paluajtshme;
- **Vendimi për dhënien e granteve:** është një vendim i Autoritetit Kontraktues për të dhënë Kontratën e Grantit për aplikuesit e suksesshëm duke finalizuar procesin e përzgjedhjes;

- **Kontrata e dhënies së Grantit:** është dokumenti ligjor në bazë të të cilit kontributi i përgjithshëm i pranueshëm publik do të rimbursohet tek përfituesi pas përfundimit të investimit;
- **Kontributi i Unionit:** është shuma e kontributit financiar të siguruar nga Buxheti i Bashkimit Evropian, i cili është i barabartë me 75% të kontributit të përgjithshëm publik;
- **Kontributi kombëtar:** është shuma e kontributit financiar të siguruar nga Buxheti i Qeverisë së Shqipërisë, i cili është i barabartë me 25% të kontributit të përgjithshëm publik;
- **Kontributi publik:** është shuma e fondeve publike origjina e të cilave është nga buxheti i autoriteteve publike (Bashkimi Evropian dhe Kombëtar) për financimin e investimeve;
- **Kontributi privat:** shuma e fondeve private në shumën totale të investimit;
- **Shpenzimet e pranueshme:** janë shpenzimet e miratuara në përputhje me Listën e Shpenzimeve të Pranueshme të paraqitura në Shtojcën 6 të këtij Udhëzimi për Aplikuesit;
- **Zona malore:** zonat në Shqipëri të listuara në Aneksin 7 të këtij Udhëzuesi për Aplikuesit;
- **Fermeri i ri:** një fermer nën moshën 40 vjeç në kohën e aplikimit;
- **Ndërmarrje:** një person juridik që mund të përbëhet nga një ose më shumë stabilimente (njësitë prodhuese / përpunuese lokale);
- **Stabiliment:** është një njësi lokale e prodhimit e cila nuk është e regjistruar si person juridik, që i takon një ndërmarrjeje të pranueshme për tu mbështetur sipas kësaj skeme granti;
- **Rindërtimi:** rinovimi/ rinovimi i një ndërtese/ objekti ekzistues (me përjashtim të shteses);
- **Ndërtimi:** ndërtimi i një ndërtese të re/ objekti të ri të një ndërmarrjeje/ ndërmarrjeje ekzistuese bujqësore;
- **Rinovimi:** është një aktivitet ndërtimi për të rikthyer një ndërtesë në një formë më të mirë (si duke e pastruar, riparuar ose rindërtuar).

4. Masa 7: “Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Biznesit”

4.1 Intensiteti i ndihmës nën Masën 7

Sipas Masës 7, shpenzimet totale të pranueshme për të cilat mund të kërkohet një grant minimumi dhe maksimumi duhet të jetë:

- **shuma minimale:** 10,000 EURO
- **shuma maksimale:** 400,000 EURO

Përqindja e mbështetjes publike është e barabartë me 65% të totalit të kostove të pranueshme të investimit.

Kontributi i BE-së është i barabartë me 75 % të totalit të mbështetjes publike.

Një aplikant mund të jetë përfituesi i më shumë se një projekti investimi, por totali i kostove të pranueshme të investimeve për aplikant, për këtë masë, nuk duhet ta kalojë vlerën prej 600,000 Euro për të gjithë kohëzgjatjen e periudhës së programit.

4.2 Aplikantët e pranueshëm nën Masën 7

Marrësit e mbështetjes janë:

- i) Marrësit e mbështetjes janë persona fizikë ose juridikë, përfshirë kooperativat, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të përfshirë në regjistrin kombëtar të fermës ose - derisa të krijohet regjistri i fermës –regjistrat rajonale të fermës të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- ii) Mikrosipërmarrjet dhe sipërmarrjet e vogla private jo-bujqësore të cilët punësojnë më pak se 50 persona dhe xhiroja vjetore e të cilave nuk e kalon vlerën 2.4 milion EURO, dhe/ose me një bilanc vjetor totali i të cilit nuk e kalon vlerën 2.4 milion EURO (që korrespondon me Aneksin 4. Madhësia e ndërmarrjes përcaktohet duke marrë në konsideratë lidhjet me kompanitë partnere.

Të pranueshme për të gjithë sektorët, janë:

- sipërmarrjet private, të themeluara dhe/ ose që kryejnë veprimtarinë e tyre në zonat rurale, të regjistruara si persona fizik ose juridik në QKB;
- subjektet private që janë të vendosura jashtë zonave rurale, gjithashtu mund të jenë të pranueshëm, nëse investimet për të cilat kërkohet mbështetje do të kryhen në zonat rurale;
- nga kapitali i marrësit të mbështetjes, jo më shumë se 25% mund të jetë në zotërim të një ose disa personave juridik publik;

Marrësit e mbështetjes kanë përgjegjësinë e zbatimit dhe të financimit të investimit.

Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë nën Masën 7

- Vendodhja e investimit të mbështetur duhet të jetë në një nga zonat rurale të renditura në Aneksin 7.
- Të gjithë projektet e mbështetura duhet të përmbushin standardet minimale përkatëse kombëtare deri në përfundimin e investimit.
- Aplikanti duhet të ketë aftësitë përkatëse profesionale, në rastin kur ato përcaktohen në legjislacionin përkatës.
- Aplikanti duhet të paraqesë një projekt propozimi teknik ose plan biznesi që vërteton rentabilitetin ekonomik të investimit në përfundim të realizimit të investimit.
- Mbështetja do t'i jepet vetëm investimeve që do të zbatohen pas nënshkrimit të Kontratës së Grantit. Pranohen vetëm shpenzimet e përgjithshme që realizohen para dorëzimit të aplikimit dhe cilat janë aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e projektit të investimit (përgatitja e planeve të biznesit, projekti teknik, etj.).

- Projektet e investimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e planeve të menaxhimit të zonave natyrore të mbrojtura ose të trashëgimisë kulturore, nëse ka të tilla, të cilat mbulojnë territorin ku gjendet vendndodhja e investimit subjekt i mbështetjes.
- Në rastet kur, MBZHR ka miratuar strategji lokale të zhvillimit rural, projektet e mbështetura në këtë masë duhet që të marrin vërtetim nga ana e grupit të veprimit lokal përkatës lidhur me faktin e të qënies në përputhje me këto strategji.
- Investimet në sektorët e mëposhtëm nuk janë të pranueshëm – tregtia me pakicë, me përjashtim të dyqaneve të specializuara në shitjen e suvenireve dhe artizanatit tradicional, ose dyqaneve të specializuara në pronësi të fermerëve për shitjen e prodhimeve bujqësore dhe produkteve nga përpunimi i prodhimeve bujqësore.
- Aplikantët duhet të kenë përmbushur të gjitha detyrimet në lidhje me pagesat e taksave, përfshirë taksën e tokës, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nuk duhet të jenë në listën e borxhit të AZHBR-së dhe MBZHR-së;
- Aplikanti nuk mund të dorëzojë një aplikim të ri në këtë masë përpara autorizimit të pagesës përfundimtare në bazë të një kontrate granti të mëparshme.

Kriteret specifike të pranueshmërisë nën Masën 7

- Lidhur me sektorin e turizmit të natyrës dhe atij rural, investimet në ambientet e akomodimit kufizohen deri në një total prej 40 shtretër;
- Investimet për ngritjen e akomodimeve turistike kufizohen në ndërtimin dhe/ose rindërtimin e shtëpive dhe ndërtesave sipas stilit tradicional;

Në rastet e investimeve në impiantet e energjisë se rinovueshme, përmes kësaj mase do të mbështeten vetëm investimet e ndërmarrja si pjese integrale e një investimi (projekti) të ndërmarrë në kuadër të dy sektorëve që mbështeten nga kjo thirrje. (Turizmi i natyrës dhe ai rural; Industria e artizanatit dhe manufakturës);

4.3 Investimet e pranueshme nën Masën 7

Kohëzgjatja

Periudha e zbatimit të veprimit të investimit (projektit) të planifikuar duhet të përcaktohet në kontratat individuale për dhënien e granteve ndërmjet AZHBR dhe përfituesve.

Afati i periudhës së zbatimit të planifikuar të investimit duhet të jetë përpara dorëzimit të Kërkesës për Pagesë.

Vendndodhja

Investimet duhet të zbatohen në zonat rurale, siç renditen në Aneksin 7.

Sektorët e pranueshëm

Sipas Masës 7, janë të pranueshme investimet në sektorët e mëposhtëm primarë bujqësorë :

- 1) Turizmi i natyrës dhe ai rural;
- 2) Industria e artizanatit dhe manufakturës ;

Objektivat specifike sipas sektorit dhe investimet e pranueshme janë dhënë më poshtë. Një aplikim mund të synojë **një ose më shumë objektiva të një sektori**. Një listë e detajuar e shpenzimeve të pranueshme është dhënë në Aneksin 6.

Shembuj të investimeve të lejueshme

1. Natyra dhe turizmi rural:

- Ndërtimi dhe /ose rindërtimi i shtëpive dhe ndërtesave ne stilin tradicional të cilat të mund të përdoren për aktivitete që lidhen me turizmin dhe që mund të shërbejnë si atraksione turistike dhe pajisjet përkatëse;
- Ndërtimi dhe / ose rindërtimi i objekteve dhe blerja e pajisjeve për sport dhe aktivitete rekreative.

2. Punimet e artizanatit dhe industria e manufakturës:

- Ndërtimi dhe/ ose rikonstruksioni i objekteve dhe pajisjeve për prodhimin e produkteve tradicionale të artizanatit, duke përfshirë edhe shërbimet që i mundësojnë klientëve për të marrë pjesë në aktivitete artizanale;
- Pajisje të specializuara për prodhimin në shkallë të vogël, të tilla si përpunimi i drurit dhe tekstileve;

- .

Detaje të mëtejshme jepen në Aneksin 6: Listën e Shpenzimeve të Pranueshme.

5. Rregullat për shpenzimet e pranueshme

5.1 Shpenzime të Pranueshme

Kriteret e pranueshmërisë të aplikueshme për të gjitha masat

- i) ndërtimi apo përmirësimi i pasurive të paluajtshme, deri në masën e vlerës së tregut të pasurisë;
- ii) blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, përfshirë programe kompjuterike, deri në masën e vlerës së tregut të pasurisë;
- iii) kostot e përgjithshme që lidhen me shpenzimet e investimet (i) dhe (ii), si p.sh. tarifatat e konsulencës të tilla si ato për arkitektë, inxhinierë etj, studime fizibiliteti, përgatitja e planit të biznesit, do të jenë të pranueshme për t'u rimbursuar deri në një tavan prej

12% të kostove të përcaktuara në pikat (i) dhe (ii). Maksimumi i shpenzimeve për përgatitjen e planit të biznesit duhet të jetë 4% i kostove të përmendura në pikat (i) dhe (ii) pa e kaluar vlerën e barabartë me 5 000 Euro. Kostot e përgjithshme konsiderohen të pranueshme nëse projekti të cilit i përkasin është përzgjedhur dhe është kontraktuar prej AZHBR.

Aplikanti duhet të provojë pronësinë mbi tokën/ ndërtesën ose ndërtesat të lidhura me investimin ose të drejtën e përdorimit me afat të paktën 10 vjet që nga data e dorëzimit të aplikimit. Në rastin e investimeve në pasuri të paluajtshme, ujitje, ose bimë shumëvjeçare, aplikanti duhet të provojë pronësinë mbi tokën/ ndërtesat e lidhura me investimin ose të drejtën e përdorimit të tyre për një periudhë të paktën 10 vjet nga data e dorëzimit të aplikimit.

Janë të pranueshme vetëm shpenzime të bëra pas firmosjes së kontratës së grantit mes marrësit të mbështetjes dhe AZHBR (me përjashtim të kostove të përgjithshme sipas seksionit 5.1 - iii).

Projektet e investimeve mbeten të pranueshme për t'u financuar nga BE-ja në të ardhmen, me kusht që të mos i nënshtrohen modifikimeve thelbësore brenda pesë vitesh nga pagesa e fundit e AZHBR, të tilla si:

- ndërprerje apo zhvendosje e aktivitetit prodhues jashtë zonës gjeografike që mbulon programi IPARD II;
- ndryshime në strukturën e pronësisë, që i japin një subjekti apo organi publik një avantazh të padrejtë;
- ndryshime thelbësore që çenojnë natyrën, objektivat apo kushtet e zbatimit, që rezultojnë në dëmtimin e objektivave fillestarë.

Në përcaktimin e pjesës së shpenzimeve publike si përqindje e totalit të kostove të pranueshme të investimit nuk merret parasysh ndihma kombëtare e dhënë me synim lehtësimin e aksesit në huamarrje pa pjesëmarrjen e kontributit të BE-së në kuadër të Rregullores (BE) Nr. 231/2014.

Të gjitha pajisjet dhe mallrat e blera **duhet të jenë të reja.**

Të gjitha pajisjet e blera në kuadër të këtij programi duhet të kenë origjinë nga një prej vendet në vijim:

- a) Shtetet Anëtare, përfituesit e IPA II, palët kontraktuese të Marrëveshjes në Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendet partnere të mbuluara nga Instrumenti European i Fqinjësisë, të listuara në Aneksi 8, Pjesa (a) dhe
- b) Vendet për të cilat qasja reciproke në asistencën e jashtme përcaktohet nga Komisioni, të listuar në Aneksin 8, pjesa (b).

Megjithatë, furnizimet mund të vijnë nga çdo vend në rastet kur shuma e investimit të propozuar është më e vogël se 100.000 Euro.

Në rastet kur furnizimet vijnë nga vendet jashtë vendeve të përmendura në pikat (a) dhe (b), aplikanti duhet që të vërtetojë se standardet respektive të BE-së, të kërkuara, do të përmbushen.

Ofertuesit, aplikantët dhe kandidatët nga vendet jo të lejueshme ose mallrat me origjinë jo të pranueshme mund të pranohen nga Komisioni në rast urgjence ose në mungesë të produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve përkatëse, ose në raste të tjera të arsyeshme zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do ta bënte realizimin e një projekti, programi ose veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

5.2 Shpenzimet jo të pranueshme

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme për mbështetje nga Programi IPARD II:

- taksat, përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar;
- tarifat doganore dhe tarifat e importit, ose detyrime të tjera me efekt të barasvlefshëm;
- blerja, dhënia ose marrja me qira e tokës ose ndërtesave ekzistuese, pavarësisht faktit nëse qiramarrja rezulton në transferim të pronësisë tek qiramarrësi;
- gjobat, penalitetet financiare dhe shpenzimet për padi gjyqësore;
- shpenzimet operative;
- pajisjet dhe makineritë e përdorura;
- tarifat bankare, kostot e garancive dhe detyrime të tjera të ngjashme;
- tarifat e këmbimit valutor apo humbje si pasojë e këmbimit valutor që lidhet me llogarinë në Euro të IPARD, si edhe shpenzime të tjera tërësisht financiare;
- kontribute në natyrë;
- e drejta e blerjes mbi prodhimin bujqësor, e kafshëve, e bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
- çfarëdolloj mirëmbajtjeje, amortizimi apo kosto qiraje;
- çfarëdolloj kostoje e rezultuar apo pagese e kryer nga administrata publike gjatë menaxhimit dhe zbatimit të asistencës, përfshirë ato të strukturës menaxhuese dhe operacionale dhe sidomos ato të lidhura me shpenzimet e përgjithshme, qiratë dhe pagat e personelit të punësuar për aktivitetet e menaxhimit, zbatimit, monitorimit dhe kontrollit, përveç rasteve të justifikuara për nga natyra e masës së programit IPARD II.
- shpenzimet për ato projekte investimi të cilat, para përfundimit, kanë aplikuar tarifa për përdoruesit ose pjesëmarrësit, me përjashtim të rastit kur tarifat e arkëtuara janë zbritur nga kostot për të cilat kërkohet rimbursim;
- kostot promocionale, të ndryshme nga ato të cilat janë në interesin e publikut të gjerë;
- shpenzimet e bëra nga marrësi i mbështetjes, nga kapitali i të cilit, më shumë se 25% zotërohen nga një person (ose persona) juridik publik, me përjashtim të rastit kur Komisioni ka vendosur të kundërtën bazuar në kërkesën e arsyetuar të Autoritetit Menaxhues..

6. Procedura e Aplikimit

6.1 Përmbajtja e Aplikimit

Aplikantët duhet të dorëzojnë Formularin e Aplikimit, Propozimet Teknike të Projektit ose Planin e Biznesit dhe dokumentet mbështetëse të listuar në Formularin e Aplikimit respektiv të masës.

Aplikantët duhet të aplikojnë në gjuhën shqipe.

Aplikimet duhet të paraqiten të shtypura në kompjuter dhe jo me shkrim dore. **Aplikimet, teksti i të cilave është shkruar me shkrim dore do të refuzohen.**

Aplikantët duhet të dorëzojnë:

1. **Formularin e Aplikimit** duke përdorur modelin e dhënë në Aneksin 1:

Aneksi 1.1 për Masën 7.

Formulari i aplikimit duhet të plotësohet në çdo seksion dhe dorëzohet në origjinal, i printuar dhe firmosur dhe në format elektronik. Format i elektronik i formularit të aplikimit duhet të ketë të njëjtën përmbajtje me versionin e printuar.

2. **Projektet me kosto totale të pranueshme të investimit që nuk tejkalojnë 50,000 Euro** duhet të dorëzojnë Propozimin Teknik të Projektit që përmban deklaratën e të ardhurave të thjeshtuara dhe llogarinë rrjedhëse duke përdorur modelin e dhënë në Aneksin 3 të Udhëzuesit.

3. **Projektet me kosto totale të pranueshme të investimit mbi 50,000 Euro** duhet të dorëzojnë Planin e Biznesit që përbëhet nga pjesa narrative dhe financiare e dhënë në Aneksin 2 të Udhëzuesit.

- Pjesa përshkuese e Planit të Biznesit duhet të përgatitet duke përdorur modelin e dhënë në Aneksin 2.1 dhe duhet të dorëzohet në origjinal, e printuar dhe në format elektronik (CD-Rom);
- Pjesa Financiare e Planit të Biznesit duhet të përgatitet duke përdorur modelin e dhënë në Aneksin 2.2 dhe të dorëzohet i printuar dhe në format elektronik (CD-Rom).
- Tabela 1 e Pjesës Financiare duhet të përmbajë detajim zë për zë të shpenzimeve të pranueshme sipas ofertave të paraqitura.

Çdo gabim apo mospërputhje në lidhje me pikat e përmendura në Formularin e Aplikimit dhe Planin e Biznesit apo çdo mospërputhje tjetër në Formularin e Aplikimit mund të çojë në refuzimin e aplikimit.

Sqarime do të kërkohen vetëm atëherë kur informacioni i dhënë është i paqartë, dhe si pasojë pengon në këtë mënyrë Autoritetin kontraktues që të kryejë një vlerësim objektiv.

4. Aplikimet duhet të shoqërohen me dokumente mbështetëse, për verifikimin e të drejtës së aplikuesit, investimet dhe shpenzimet.

Dokumentet mbështetëse të kërkuara duhet të jepen në origjinal ose në formën e fotokopjeve të noterizuara siç tregohet për secilin dokument në Formularin e Aplikimit dhënë në Aneksin 1.1 për të cilën është dorëzuar aplikimi.

Nëse dokumentet origjinale nuk janë të lëshuara në gjuhën Shqipe, atyre duhet t'u bashkëngjitet një përkthim zyrtar në gjuhën Shqipe. Duhet të dorëzohen dokumentet mbështetëse të mëposhtme :

- 1) Dokumentet që verifikojnë **pranueshmërinë e aplikantit**, të renditura në Formularin e Aplikimit;
- 2) Dokumentet që verifikojnë **pranueshmërinë e investimeve**, të renditura në Formularin e Aplikimit;
- 3) Ofertat origjinale për të **gjithë zërat e investimit** (projektit);
- 4) Fotokopjet e faturave të shpenzimeve të grupit të kostove të përgjithshme (të tilla si to për planet e biznesit, tarifat e arkitektëve, inxhinierëve dhe të konsulentëve të tjerë) që kanë dalë dhe janë paguar përpara bërjes së aplikimit.
- 5) Ekstraktet historike të ofertuesëve që tregojnë aksionerët dhe fushën e veprimtarisë në përputhje me objektin e ofruar.
- 6) Nuk pranohen ofertues të cilët janë OJF/ Fondacione

Lutemi vini re se për të gjithë zërat e shpenzimeve kërkohen tre oferta nga ofertues të pavarur që pasqyrojnë një kërkim real dhe të pavarur të çmimeve të tregut.

Paraqitja e ofertave jo-reale ose nga shoqëri jo të pavarura sjell refuzimin e aplikimit.

Të gjitha **ofertat** duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- Numrin e referencës / protokollin dhe datën e lëshimit;
- Emrin, adresën e ofertuesit (kompania) dhe kontaktet zyrtare;
- Numrin e regjistrimit (NIPT ose ekuivalent) të ofertuesit (kompanisë);
- Deklaratë mbi origjinën e mallrave që do të blihen (Çertifikata e Origjinës nuk kërkohet në fazën e aplikimit por duhet të dorëzohet së bashku me Kërkesën për Pagesë);
- Specifikime teknike dhe kapacitetet prodhuese (input / output) në rastin e pajisjeve dhe makinerive;
- Lista e detajuar e shpenzimeve të përfshira në faturë, në rastin e punimeve të ndërtimit/rikonstruksioneve;
- Çmimi, TVSH-ja dhe taksa të tjera të veçanta;
- Afatin e Vlefshmërisë të ofertës prej të paktën 6 muaj nga aplikimi;
- Nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor dhe vula, aty ku është e aplikueshme.
- Deklaratë se mallrat e ofruara janë të reja dhe të papërdorura.

Secila ofertë duhet të përfshijë gjithashtu edhe një kopje të certifikatës së regjistrimit të ofertuesit.

Ofertat duhet të jenë të krahasueshme në specifikime teknike zë për zë ose në kapacitet (Output). Në mënyrë që të vërtetohet se ofertat të jenë të krahasueshme me njëra-tjetrën, si pjesë të ofertës aplikanti duhet të kërkojë nga ofertuesi specifikimet teknike sa më të detajuara.

E rëndësishme: Kontratat me ofertuesit nuk duhet të firmosen përpara firmosjes së Kontratës së Grantit.

Kujdes: Ligji shqiptar kërkon që të gjitha kontratat e kalimit të të drejtave të përdorimit me afat mbi 9 vjet, duhet të regjistrohen në kartelat respektive të pronësisë.

6.2 Dorëzimi i Aplikimeve

Njoftimi mbi Thirrjen për dorëzimin e Aplikimeve do të publikohet në media dhe në faqen e internetit të AZHBR-së www.azhbr.gov.al dhe të MBZHR www.bujqesia.gov.al.

Autoriteti Kontraktues do refuzojë të gjitha aplikimet që janë dorëzuar para publikimit të Thirrjes për Dorëzimin e Aplikimeve.

Aplikimet duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura me titullin Thirrje për Dorëzimin e Aplikimeve, së bashku me titullin e masës, emrin e plotë dhe adresën e aplikantit dhe me shënimin “Të mos hapet përpara dorëzimit”.

Aplikimet duhet të dorëzohen **ose:**

- Nëpërmjet dërgesës postare rekomande, ose
- Dorazi (duke përfshirë shërbimet korriere) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga:

<Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
Rruga “Muhamet Gjollësia”, Nr.56
Tiranë, Shqipëri>

Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo e-mail) apo të dërguara në adresa të tjera do të refuzohen.

Çdo aplikim i dorëzuar apo marrë pas përfundimit të afatit do të refuzohet automatikisht.

Autoriteti Kontraktues do të ketë pronësinë e të gjitha aplikimeve që do të dorëzohen. Si pasojë, aplikantët nuk do të kenë të drejtë t'i marrin mbrapsht aplikimet e tyre.

6.3 Informacione të Mëtejshme për Aplikantët

Së bashku me njoftimin për publikimin e këtij Udhëzuesi për Aplikantët do të publikohet edhe programi i takimeve informuese. Ky Udhëzues do të jetë gjithashtu i disponueshëm edhe në faqen e internetit të AZHBR-së www.azhbr.gov.al, faqes së IPARD www.ipard.gov.al dhe të MBZHR-së www.bujqesia.gov.al.

Pyetjet duhet të dërgohen në adresën (adresat) e mëposhtme, duke treguar qartësisht emrin e Skemës së Grantit:

Adresa e –mail-it: info@azhbr.gov.al

[Faks: +355 4 222 8318]

Përgjigjet do të jepen jo më vonë se 11 ditë përpara përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve. Autoriteti Kontraktues nuk është i detyruar të japë sqarime të mëtejshme pas kësaj date.

Me qëllim trajtimin e barabartë të aplikantëve, Autoriteti Kontraktues nuk mund të japë opinion paraprak mbi pranueshmërinë e një aplikimi, një partneri biznesi, një veprimi apo aktiviteteve të veçanta.

Pyetjet që mund të jenë me interes edhe për aplikantët e tjerë, së bashku me përgjigjet, do të publikohen në faqet e sipërpërmendura të internetit. Ndaj, rekomandohet konsultimi i rregullt me faqen e internetit të sipërpërmendur për t'u informuar mbi pyetjet dhe përgjigjet e publikuara.

7. Përzgjedhja, Kontraktimi dhe Zbatimi i Procedurës

7.1 Procedura e përzgjedhjes

Të gjitha aplikimet e marra përpara përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve do të shqyrtohen nga Autoriteti Kontraktues. Të gjitha aplikimet e dorëzuara do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve të mëposhtme.

7.1.1 Kontrolli i Dokumentacionit dhe i Pranueshmërisë

Në këtë fazë pranueshmëria e aplikantit, investimeve dhe shpenzimeve do të verifikohet sipas kriterëve të vendosura në Seksionin 4 të këtij Udhëzuesi për Aplikantët.

Verifikimi i pranueshmërisë dhe ai administrativ do të kryhet bazuar në dokumentet mbështetëse të dorëzuara (shih Seksionin 6, pika 6.1)

Nëse ndonjë nga dokumentet mbështetëse të kërkuara mungon ose është i paplotë, ose i papërshtatshëm nga ana administrative, aplikanti do të informohet me shkrim në mënyrë që të ridërgojë dokumentin (dokumentet) brenda **15** ditëve pune. Nëse dokumentet nuk dorëzohen brenda këtij afati aplikimi do të refuzohet.

Dita e nesërme e marrjes së njoftimit është dita e parë e numëruar nga 15 ditët e punës në dispozicion. Nëse dita e 15-të është ditë pushimi, dita e parë e punës, pas pushimit, bëhet dita

e fundit e lejuar për dorëzimin e dokumentacionit në AZHBR. Nëse dokumentet nuk dorëzohen brenda këtij afati aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit, zbulohet se aplikanti ose investimi nuk i plotëson kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në Seksionin 4, aplikimi refuzohet.

7.1.2 Vlerësimi i Propozimit Teknik të Projektit dhe/ose Planit të Biznesit

Aplikimet që kanë kaluar kontrollin e parë administrativ dhe të përshtatshmërisë do të vlerësohen për qëndrueshmërinë ekonomike të planit të biznesit.

Mbi bazën e informacionit të dhënë në Propozimin Teknik të Projektit:

Investimi do të konsiderohet ekonomikisht i realizueshëm dhe i pranueshëm nëse:

- **Për Investimet deri në 50,000 EUR**
- **Fitimi Neto ≥ 0 ; dhe,**
- **Shuma kumulative e fluksit të arkës ≥ 0 .**
- **Per investimet mbi 50,000 EUR**
- **Fitimi Neto ≥ 0 ; dhe,**
- **IRR \geq me normën Bazë 1%.**

Mbi bazën e informacionit të dhënë në planin e biznesit do të përlllogariten raportet e mëposhtme financiare:

Vlera Aktuale Neto (NPV, net present value): përkufizohet si vlera aktuale e flukseve neto të parasë. Ajo analizon përfitimin nga plani i investimit. NPV llogaritet vlerën e zbritur të fluksit të ardhshëm të parave të një investimi. Për vlerësimin e planit të biznesit, dhe të fluksit të parave të gjeneruara nga investimi do të përdoret norma e zbritshme prej 1%. Që të konsiderohet fitim-prurës, plani i biznesit duhet të ketë një vlerë aktuale neto të barabartë ose më të madhe se zero për normën e zbritshme prej 1%.

Norma e Brendshme e Kthimit (IRR, internal rate of return): Norma e brendshme e kthimit llogaritet duke gjetur normën e zbritshme, që është e barabartë me vlerën aktuale të fluksit të parave neto. IRR është norma vjetore e kthimit e përbërë, e cila mund të fitohet mbi kapitalin e investuar. Një projekt është një propozim i mirë investimi nëse IRR është më e lartë se kostoja e kapitalit të projektit, ose nëse është më e lartë se norma e kthimit, që mund të fitohet nga investimet alternative. Prandaj minimumi i IRR që investimi (projekti) të pranohet, duhet të jetë e barabartë me ose më e madhe se 1%.

Pra, investimi mbi 50,000 EUR do të konsiderohet ekonomikisht i realizueshëm dhe i pranueshëm nëse:

- **NPV ≥ 0 ; dhe,**
- **IRR \geq norma e zbritshme (1%).**

7.1.3 Kontrollat në Vend

Të gjitha aplikimet të cilat përmbushin rregullat administrative dhe ato të pranueshmërisë do të kontrollohen në vend për të verifikuar nëse informacioni i dorëzuar në formularin e aplikimit është i saktë. Aplikantët do të kontrollohen nga ekspertë të AZHBR dhe nga Autoritet e tjera Kombëtare/ Trupat Teknike të cilët do të verifikojnë standardet minimale kombëtare përkatëse të projektit të investimit të planifikuar. Gjatë kontrolleve në vend do të kontrollohen dokumentet dhe asetet.

Nëse nga kontrollet në vend del se aplikanti ose investimi nuk përmbush standardet minimale kombëtare dhe/ ose kriteret e pranueshmërisë të kërkuara dhe të përcaktuara në Seksionin 4, atëherë aplikimi do të refuzohet.

7.1.4 Renditja e Aplikimeve

Të gjithë aplikimet e pranueshme që kanë kaluar fazën e parë të kontrollit administrativ do të renditen sipas kriterëve të dhena në tabelën e mëposhtme.

Kriteret e përzgjedhjes për Masën 7: Diversifikimi Fermave dhe Zhvillimi Biznesit

Kriteret		Pikët
1	Investimi është kryer në një nga zonat malore të renditura në Aneksin 7	15
2	Investime në prodhimin e energjisë së rinovueshme	10
3	Aplikanti (ferma bujqësore) është e certifikuar për prodhim organik në përputhje me ligjin në fuqi për bujqësinë organike	15
4	Aplikanti është femër ose subjekt i cili të paktën 30% të të punësuarve i ka femra	15
5	Aplikanti është fermer i ri (jo më shumë se 40 vjeç në momentin e dorëzimit të aplikimit)	15
6	Në bazë të planit të biznesit projekti parashikon hapjen e vendeve të reja të punës	30
7	Totali (maksimumi)	100

Sipas kësaj renditjeje, do të përzgjidhen aplikimet me pikët më të larta, deri në kufirin maksimal të buxhetit të thirrjes.

Nëse buxheti nuk është i mjaftueshëm për të financuar dy apo më tepër aplikime, të cilat janë të renditura me pikë të barabarta, granti do të jepet aplikimit të dorëzuar më përpara, sipas parimit aplikimi i dorëzuar i pari - përfiton i pari.

Nëse pas kontraktimit të listës kryesore, pavarësisht nga arsyeja, buxheti total i thirrjes për dorëzimin e aplikimeve nuk është kontraktuar i tëri, atëherë do të kontraktohen projektet nga lista rezervë që do të hartohet për këtë qëllim.

7.2 Vendimi për Dhënien e Grantit dhe Njoftimi i Aplikantëve

Aplikantët do të njoftohen me shkrim lidhur me vendimin e Autoritetit Kontraktues për sa i përket aplikimit të tyre dhe në rast të refuzimit të aplikimit edhe për arsyt e refuzimit.

Aplikantët që besojnë se janë dëmtuar nga ndonjë gabim apo parregullsi gjatë procesit të vendimit për dhënien e grantit mund të depozitojnë një ankesë. Ankimimi duhet të dorëzohet me shkrim dhe i firmosur nga aplikanti. Ankimimi duhet ti referohet arsyeve të vendimit të marrë nga ana e Autoritetit Kontraktues. Vendimi për pranimin apo refuzimin e ankimimit i drejtohet aplikantit brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative, brenda 30 ditëve, referuar Nenit 140 të KPA. Pas marrjes së vendimit në rastet e refuzimit të ankimimit, aplikantit i rezervohet e drejta për ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda afatit 45 ditësh të përcaktuar në Nenin 18 të Ligjit 49/2012 për “Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative”.

7.3 Kushte të Zbatueshme për Kryerjen e Investimeve

Në vijim të vendimit për dhënien e grantit, përfituesit do t’i ofrohet një kontratë granti e cila do të jetë e disponueshme në faqen e internetit të AZHBR, www.azhbr.gov.al, të faqes IPARD www.ipard.gov.al dhe të MBZHR www.bujqesia.gov.al. Duke firmosur Formularin e Aplikimit (Aneksin 1.1 të këtij Udhëzimi i për masën për të cilën aplikon), aplikanti deklaron se pranon, në rast dhënieje të grantit, kushtet kontraktuale të përcaktuara në kontratën e grantit.

7.4 Pagesa e Grantit

Granti paguhet në një dhe/ose dy këste:

- 1) Pagesa paraprake e përfituesit cilësohet nga autoriteti kontraktues si shpenzim i pranueshëm deri në 50% të ndihmës publike lidhur me projektin, do t’i nënshtrohet vendosjes së një garancie bankare ose ekuivalente me të (me vlefshmëri deri në 6- muaj deri në datën e përfundimit të investimit të përcaktuar në kontratë), që do t’i korrespondojë 110 % të shumës parapaguar.
- 2) Diferenca pas kryerjes së investimeve dhe pagesës së të gjitha shpenzimeve ndaj furnizuesve/sipërmarrësit të punimeve, brenda datës së specifikuar në Kontratën e Grantit, marrësi duhet të paraqesë Kërkesë për Pagesë jo më vonë se data e specifikuar në Kontratën e Grantit.

Kërkesat për pagesë mund të shkarkohen nga faqet e internetit www.ipard.gov.al, www.azhbr.gov.al ose www.bujqesia.gov.al, dhe duhet të dorëzohen së bashku me të gjitha dokumentet e tjera mbështetëse të kërkuara siç tregohet në Aneksin 4.1 për Masën 7.

Pas dorëzimit së kërkesës për pagesë, AZHBR kontrollon plotësimin, vlefshmërinë dhe pranueshmërinë e kërkesave për pagesë gjatë kontrollit administrativ. Nëse ndonjë nga dokumentet mbështetëse të kërkuara mungon ose është i paplotë, ose i papërshtatshëm nga ana administrative, aplikanti do të informohet me shkrim në mënyrë që të dërgojë dokumentin (dokumentet) brenda 15 ditëve pune.

Dita e nesërme e marrjes së njoftimit është dita e parë e numëruar nga 15 ditët e punës në dispozicion. Nëse dita e 15-të është ditë pushimi, dita e parë e punës, pas pushimit, bëhet dita e fundit e lejuar për dorëzimin e dokumentacionit në AZHBR. Nëse dokumentet nuk dorëzohen brenda këtij afati kërkesa për pagesë do të refuzohet.

Pas kësaj, duhet të kryhet kontrolli në vend për të verifikuar, që pajisjet dhe makineritë janë vendosur dhe funksionojnë, punimet kanë përfunduar dhe të gjitha pagesat ndaj furnizuesve janë kryer. Pas përfundimit të të gjitha kontrolleve administrative dhe në vend (dokumentacioni), AZHBR do të llogarisë shumën përfundimtare të grantit dhe do të autorizojë pagesën tek përfituesi.

Të gjitha pagesat e bëra nga përfituesi pas datës së përfundimit të investimit, të specifikuar në Kontratë, do të konsiderohen **si shpenzime të papranueshme**. Granti do të transferohet në llogarinë bankare të përfituesit, pas autorizimit të pagesës. AZHBR do të transferojë kontributin kombëtar dhe të BE-së si pagesë përfundimtare të autorizuar në llogarinë bankare të marrësit në lekë (ALL).

Shenim: Pagesat Cash nuk janë të lejuara.

7.4.1 Përmbajtja e kërkesës për pagesë

- 1. Aplikantët duhet të dorëzojnë Kërkesën për Pagesë** dhe të gjitha dokumentet mbështetëse të përshkruara më poshtë. Aplikantët duhet të aplikojnë në gjuhën shqipe. Dokumentet duhet të jenë të shkruara në formë elektronike. Aplikimet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.
- 2. Kërkesa për pagesë** bëhet duke përdorur formatin e dhënë në:
Aneksin 4.1 për Masën 7;

Kërkesa për Pagesë duhet të dorëzohet origjinale e printuar, sipas formateve të miratuara për thirrjen e 4-të.

- 3. Kërkesa për pagesë** duhet të shoqërohet me dokumente mbështetëse, për të lejuar verifikimin e përshtatshmërisë së aplikuesit, investimet dhe shpenzimet. Dokumentet mbështetëse të kërkuara duhet të dorëzohen në formë origjinale ose fotokopje të vërtetuara nga përfaqësuesi ligjor ose noteri, siç tregohet për çdo dokument në Kërkesën për pagesë të dhënë si Aneksi 4.1.

Nëse dokumentet mbështetëse nuk janë lëshuar në gjuhën shqipe duhet të bashkëngjitet një përkthim zyrtar në gjuhën shqipe. Duhet të dorëzohen grupet e mëposhtme të dokumenteve mbështetëse:

- Dokumentet që vërtetojnë **pranueshmërinë e aplikantit**, të listuara në Kërkesën për pagesë;
- Dokumentet që vërtetojnë **përshtatshmërinë e investimeve**, të listuara në Kërkesën për pagesë;
- Faturat origjinale për të gjitha zërat e shpenzimeve të procesit të investimit (projektit), siç janë edhe shpenzimet e përgjithshme të shpenzimeve (planet e biznesit, arkitektët, inxhinierët dhe tarifat e tjera të konsulencës) të bëra dhe të paguara para aplikimit.

7.4.2 Dorëzimi i Kërkesës për Pagesë

Kërkesa për pagesë duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe duhet të mbajë titullin e Thirrjes për Propozime, së bashku me titullin e masës, emrin dhe adresën e plotë të aplikuesit dhe fjalët "Të mos hapet para dorëzimit".

Kërkesat për pagesë duhet të dorëzohen ose:

- me dërgesë të regjistruar me postë; ose
- dorëzuar me dorë (duke përfshirë shërbimet korrierre) direkt tek Autoriteti Kontraktor në këmbim të një fature të nënshkruar me datë për:

<Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
Rruga Muhamet Gjollësia Nr.56
1001 Tiranë, Shqipëri>

Shënim: Kërkesa për pagesë e dërguar me anë të ndonjë mënyre tjetër (p.sh. me faks ose me e-mail) ose dorëzuar në adresa të tjera do të refuzohet.

Çdo kërkesë për pagesën e dorëzuar ose pranuar pas afatit përfundimtar, të specifikuar në Kontratën e Grantit, do të refuzohet automatikisht.

Autoriteti Kontraktues mban pronësinë e të gjithëdokumentacionit të kërkesave për pagesëtë pranuar. Rrjedhimisht, aplikantët kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e dokumentacionit original, që lidhet me pagesat me kusht, që të ruajnë dokumentacionin origjinal për aq kohë sa Kontrata e grantit është në fuqi.

7.4.3 Informacione të Mëtejshme për Aplikantët

Në njoftimin e publikimit të këtij Udhëzuesi për Aplikantët publikohet orari i takimeve informuese. Gjithashtu është në dispozicion në faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al, www.ipard.gov.al dhe të MBZHR www.bujqesia.gov.al.

Pyetjet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme, duke treguar qartë emrin e Skemës së Grantit:

E-mail adresa: info@azhbr.gov.al

Faksi: + 355 4 222 8318.

Pyetjet mund të dërgohen me e-mail ose me faks jo më vonë se 10 ditë para afatit të fundit për dorëzimin e kërkesës për pagesë. Përgjigjet do të jepen jo më vonë se 10 ditë para afatit për dorëzimin e kërkesës për pagesë. Autoriteti Kontraktor nuk ka asnjë detyrim të japë sqarime të mëtejshme pas kësaj date.

7.5 Monitorimi ex-post

Verifikimet ex-post do të kryhen brenda pesë viteve nga data e pagesës përfundimtare tek marrësi. Të gjitha investimet duhet të kontrollohen së paku një herë gjatë periudhës 5-vjeçare. Verifikimet ex-post do të kryhen në investime për të verifikuar respektimin e kriterëve të përcaktuara në programin IPARD II.

8. Shënime të Rëndësishme për Aplikantin lidhur me Refuzimin e Aplikimeve

Nëse disa nga kërkesat formale të përcaktuara më sipër nuk respektohen plotësisht, reagimi do të jetë në të njëjtën masë me gabimet e identifikuara duke zbatuar trajtimin e barabartë të aplikantëve potencialë:

A. Për gabime të mëdha në kërkesat formale aplikimet do të refuzohen në fazën e parë të shqyrtimit.

Gabimet e mëposhtme do të konsiderohen si gabime të mëdha:

- Aplikimet e dorëzuara pas përfundimit të afatit;
- Mungesa e Formularit të Aplikimit, Pjesës Përshkuese ose Financiare të Planit të Biznesit;
- Mospërdorimi i modelit standard të Formularit të Aplikimit apo të Planit të Biznesit të miratuar për për thirrjen e 4-të;
- Aplikimi apo Plani i Biznesit është i shkruajtur me shkrim dore;
- Mungesa e listës së detajuar të zërave të investimit (Sheet 1, Tabela e shpenzimeve të pranueshme);
- Mungesa e dokumenteve mbështetëse të bashkangjitura me formularin e aplikimit;
- Mungesa e ofertave;
- I njëjti aplikant ka dorëzuar dy aplikime brenda një thirrje, për të njëjtën masë.
- Aplikanti ka dorëzuar një aplikim të mëparshëm në kuadër të thirrjeve të mëparshme për aplikim në programin IPARD nën të njëjtën masë, aplikim i cili ndodhet në procesin e vlerësimit dhe nuk i është dorëzuar aplikantit një njoftim zyrtar për refuzimin / apo pagesa përfundimtare nuk është autorizuar akoma.
- Shuma totale e parashikuar e shpenzimeve të pranueshme është mbi limitet e lejuara për masën.

Masa 7 (10.000 EUR – 400.000 EUR)

B. Për gabime më të vogla do të kërkohen sqarime/ridërgim të dokumenteve që mungojnë.

Gabimet e mëposhtme do të konsiderohen si gabime të vogla:

- Formulari i Aplikimit dhe pjesa Përshkuese e Planit të Biznesit është dorëzuar sipas modelit të duhur të miratuar për thirrjen e 4-rt dhe informacioni i kërkuar është dhënë,

por mënyra në të cilën janë plotësuar dokumentet është e pasaktë, p.sh. informacioni është dhënë në seksioni X ndërkohë që duhej të jepej në seksionin Y;

- CD-ja me informacionet financiare të planit të biznesit është e bashkangjitur, por dokumenti në Excel nuk mund të hapet;
- Dokumenti në Excel hapet, por disa nga informacionet janë të paplota dhe raportet financiare nuk janë të llogaritura saktë; nëse informacioni nga aplikanti është i disponueshëm, ekspertët do ta korrigjojnë formulën pa e rikërkuar informacionin nga aplikanti;
- Nëse informacioni është i paplotë;
- Ka mospërputhje midis të dhënave të shkruara në Sheet 1, Tabela e shpenzimeve të pranueshme dhe ofertave të dorëzuara;
- Propozimi/ deklaratat nuk është firmosur apo mban një nënshkrim të skanuar;
- Mungon një pjesë e dokumenteve mbështetëse;
- Vlefshmëria e dokumenteve ka skaduar;
- Është përdorur formati i gabuar i dokumentit mbështetës ose dokumenti nuk është shkruar saktë.

Aplikantit do t'i jepet një afat 15 ditor pune për të ridorëzuar të gjitha dokumentet që mungojnë, dhe nëse dokumentet nuk dorëzohen brenda këtij afati apo nëse ato do të jenë sërish jo të plota, aplikimi do të refuzohet.

Kriteret e pranueshmërisë

- Aplikimet do të refuzohen në rastin kur një apo më shumë prej kriterëve të pranueshmërisë të aplikantëve apo të investimeve nuk respektohen.

Aplikimi do të refuzohet nëse :

- Kostot totale të pranueshme janë më poshtë apo më sipër kufirit të përcaktuar në Udhëzuesin për Aplikantët të miratuar për thirrjen e 4-rt;
- Nuk përmbush kriteret e Aneksit 5 (Arsye të tjera Skualifikimi)

Përpara kontraktimit do të bëhen korrigjimet e mëposhtme;

- Korrigjimi i gabimeve aritmetike;
- Fshirja e zërave të papranueshëm.
- Nëse kufijtë e kostove të përgjithshme apo të planit të biznesit tejkalohen, kostot do të reduktohen;
- Çmimi i ofertës së përzgjedhur është më i lartë se çmimi i tregut, shpenzimi do të aprovohet deri në nivelin e çmimit të tregut.

Për të gjitha rastet e tjera që nuk janë të përmendura më lart, AZHBR do të marrë vendime rast pas rasti duke zbatuar gjithmonë:

- Trajtimin e barabartë të aplikimeve dhe
- Parimin e proporcionalitetit
- Mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe Fondeve Kombëtare.

Lista e Anekseve

DOKUMENTET PËR TU DORËZUAR NGA APLIKANTI

- Aneksi 1: Formulari i Aplikimit
- Aneksi 1.1: Formulari i Aplikimit për Masën 7: Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit (në format Word)
- Aneksi 2: Biznes Plani
- Aneksi 2.1: Plani i Biznesit Pjesa 1 Pjesa Përshkuese (në format Word)
- Aneksi 2.2: Plani i Biznesit Pjesa 2 Pasqyrat Financiare (në format Excel)
- Aneksi 2.3: Instruksione për Përgatitjen e Planit të Biznesit
- Aneksi 3 Propozimet Teknike të Projektit
- Aneksi 3.1 Propozimet Teknike të Projektit Pjesa 1 Pjesa përshkuese (në format Word)
- Aneksi 3.2: Propozimet Teknike të Projektit Pjesa 2 Pasqyrat financiare (Format Exel)
- Aneksi 3.3: Instruksione për Përgatitjen e Propozimeve Teknike te Projektit
- Aneksi 4: Formati për Kërkesën për Pagesë
- Aneksi 4.1: Kërkesa për Pagesë për Masën 7

DOKUMENTET PËR INFORMACION

- Aneksi 5: Arsyet e Skualifikimit
- Aneksi 6: Lista e Shpenzimeve të Pranueshme
- Aneksi 7: Lista e Njësive të Qeverisjes Vendore të klasifikuara si Zona Malore më pak të avantazuara dhe Lista e Zonave Rurale
- Aneksi 8: Lista e Vendeve të Pranueshme të Origjinës
- Aneksi 9: Lista e produkteve përkatëse bujqësore e përfshirë në Aneksin 1 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian.
- Aneksi 10: Formati i Kontratës së Grantit
- Aneks 11: Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK)
- Aneks 11: Deklaratë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)
- Aneks 11: Deklaratë Drejtoria Rajonale e Mjedisit (DRM)
- Aneks 11: Deklaratë Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)